

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

K R Y E T A R E

Lindita NIKOLLA

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
PËR VITIN 2021**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke mbajtur në konsideratë rolin e prokurorisë në ushtrimin e ndjekjes penale, hetimin, përfaqësimin e akuzës në gjyq, ekzekutimin e vendimeve penale dhe kryerjen e detyrave të tjera të ngarkuara me ligj;

Duke vlerësuar rëndësinë e raportimit të Prokurorit të Përgjithshëm në Kuvendin e Shqipërisë për gjendjen e kriminalitetit, zbatimin e rekomandimeve parësore të Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit dhe për efektivitetin e ndjekjes penale;

Duke mbajtur parasysh rolin e Prokurorit të Përgjithshëm në nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme për prokurorët e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, për oficerët e Policisë Gjyqësore, si dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të tyre, si dhe legjislacionit përkatës;

Duke ritheksuar detyrimin e prokurorisë për të siguruar një procedim të drejtë, të barabartë, të rregullt ligjor për të mbrojtur liritë personale dhe të drejtat e njeriut, për të mbrojtur e për të forcuar rendin juridik dhe për të zbatuar Kushtetutën dhe ligjet në fuqi;

Duke ritheksuar përgjegjësitë e prokurorisë në zbatimin me sukses të reformës në drejtësinë penale;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në luftën kundër pastrimit të parave të korrupsionit, krimit të organizuar dhe terrorizmit;

Duke ritheksuar rëndësinë e bashkëpunimit të Prokurorit të Përgjithshëm me organet ekzekutive ligjzbatuese, Kuvendin e Shqipërisë, organet e tjera homologe vendase ose të huaja dhe organizatat e asistencës dhe ndihmës në raport me prokurorinë;

Duke mbajtur parasysh rëndësinë e mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave, si bazë e nevojshme për të analizuar kriminalitetin, format dhe prirjet e tij, si dhe bazë shkencore për të hartuar, zbatuar, ndryshuar dhe vlerësuar politikën penale dhe efektivitetin e institucioneve të drejtësisë penale;

Duke vlerësuar kontributin e dhënë mes opinionëve dhe sugjerimeve në procesin e hartimit të legjislacionit dhe/ose përmirësimin e tij;

Duke mbajtur në konsideratë rolin e prokurorisë në përmbushjen e detyrimeve në kuadër të integritimit evropian;

Duke mbajtur parasysh rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë të datës 14.6.2021,

Bazuar në analizën e të dhënave për kriminalitetin në vend gjatë vitit 2021, të referuara në raportin e paraqitur nga Prokurori i Përgjithshëm, Kuvendi i Shqipërisë konstaton se:

Koeficienti i kriminalitetit, sipas procedimeve penale të regjistruara, është 1002 për 100.000 banorë, ndërsa në vitin 2020 koeficienti i kriminalitetit ka qenë 979.

Grupet e veprave penale, që zënë një përqindje më të madhe në numrin e përgjithshëm të procedimeve penale të regjistruara sipas strukturës së Kodit Penal, gjatë vitit 2021 janë: veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike (28.88 %), vjedhja e pasurisë (27,86 %), pasuar nga veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës (6.90 %).

Grupet e tjera të veprave penale, që zënë një përqindje më të vogël në numrin e përgjithshëm të procedimeve penale të regjistruara sipas strukturës së Kodit Penal, janë: krimet kundër rendit kushtetues (0,01 %), krimet kundër jetës të kryera me pakujdesi (0,02 %), veprat me qëllime terroriste (0,03%), krimet kundër shëndetit të kryera me pakujdesi (0,04 %) etj.

Për sa i përket gjinisë së të pandehurve, nga numri i përgjithshëm i të pandehurve rezultojnë se 9.33% janë femra dhe 90,67 % meshkuj. Në vitin 2020 raporti i të pandehurve sipas gjinisë ishte 97,86% meshkuj dhe 2,14% femra.

Çështjet e përfunduara rezultojnë me një ulje prej 1,84% në krahasim me vitin 2020.

Çështjet e dërguara në gjykatë rezultojnë me një rritje prej 5,25% në krahasim me vitin 2020.

Çështjet e pushuara rezultojnë me një ulje prej 1,82% në krahasim me vitin 2020.

Çështjet e pezulluara rezultojnë me një ulje prej 7,84% në krahasim me vitin 2020.

Numri i të pandehurve dërguar në gjykatë është rritur me 7,3% krahasuar me vitin 2020.

Gjatë vitit u dërguan në gjykatë për pushim 4686 çështje ose me rritje 0,83% krahasuar me vitin 2020, prej të cilave 34,07% janë pushuar për mungesë fakti.

Prokuroria ka shpallur në kërkim ndërkombëtar 172 shtetas shqiptarë apo të huaj dhe ka kërkuar që Zyra Qendrore Kombëtare Interpol Tirana të procedojë me heqjen e 133 subjekteve nga listat e kërkimit ndërkombëtar. Prokuroria e Përgjithshme ka trajtuar 1254 kërkesa të ndryshme të ardhura nga autoritetet gjyqësore vendase e ato të huaja.

Janë ekzekutuar 1534 vendime për përgjime të autorizuar nga gjykata në hetimet paraprake, të zbatuara për 655 procedime penale. Është mundur interceptimi për 3412 persona të dyshuar si të përfshirë në vepra penale.

Nga të dhënat e depozituara rezultojnë se janë filluar kryesisht 125 procedime penale ose me rritje 104,91% të numrit të procedimeve të filluara kryesisht krahasuar me vitin 2020 që ishte 61 procedime.

Numri i përgjithshëm i veprave penale të referuara dhe të kallëzuara është 47512, nga të cilat vetëm 125 janë vepra penale të filluara kryesisht nga Prokurori, ose rreth 0,3% e numrit të përgjithshëm.

Kuvendi i Shqipërisë shqyrtoi:

Zbatimin e rezolutës së Kuvendit të datës 14.6.2021 “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2020”, në përmbushje të detyrimit të parashikuar në lidhjen 3, pika 5, të vendimit të Kuvendit nr. 49/2017 “Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”;

Zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021”, të miratuara në zbatim të nenit 103, pika 3, të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;

Raportin e Ministrisë së Drejtësisë për mënyrën e zbatimit nga organi i prokurorisë së rekomandimeve prioritare të dhëna nga Këshilli i Ministrave në luftën kundër kriminalitetit, në zbatim të nenit 103, pika 5, të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

Bazuar në analizën e raportit të Prokurorit të Përgjithshëm, të rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe në raportimin e ministrit të Drejtësisë për zbatimin e rekomandimeve parësore të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021, Kuvendi konstaton se:

Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar udhëzime për zbatimin nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm të rekomandimeve parësore të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021, si dhe për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e këtyre rekomandimeve.

Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar udhëzime të përgjithshme dhe planet e veprimit për të unifikuar veprimtarinë e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm dhe mbikëqyrjes së zbatimit tyre me synim rritjen e efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit.

Prokuroria e Përgjithshme, në kuadër të vijimit të bashkëpunimit ndër-institucional, ka lidhur marrëveshjen e bashkëpunimit me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike dhe për shkeljet individuale të magjistratëve prokurorë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”.

Bashkëpunimi midis organit të prokurorisë dhe institucioneve dhe agjencive ligjzbatuese është rritur.

Prokuroria e Përgjithshme ka intensifikuar marrëdhëniet me Komisionin e Policisë Gjyqësore nëpërmjet bashkëpunimit për caktimin e numrit të përgjithshëm të oficerëve të Policisë Gjyqësore të Seksioneve të Policisë Gjyqësore në prokuroritë e të gjitha niveleve të juridiksionit të përgjithshëm.

Prokuroria e Përgjithshme ka organizuar trajnime të përbashkëta në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës për hetimet financiare, evazionin fiskal dhe krimin kibernetik.

Janë zhvilluar aktivitete të ndryshme, si: trajnime, *workshop*-e dhe kurse për rritjen e kapaciteteve profesionale në fushat prioritare në kuadër të projektit PROCEEDS-2 të Këshillit të Europës dhe në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit miratuar mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe prezencës së OSBE-së me fokus “Veprimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri”.

Me gjithë arritjet për vitin 2021, vijon të mbetet i ulët roli proaktiv i prokurorit për çështje të filluara kryesisht, veçanërisht në lidhje me veprat penale kundër korrupsionit.

Lidhur me veprën penale të dhunës në familje, vihet re rritje e numrit të çështjeve të regjistruara, por sipas raportit të Ministrisë së Drejtësisë duhet punuar në drejtim të ashpërsimit të politikës penale nga gjykatat.

Vlerësohet analiza e veprave penale sipas strukturës së Kodit Penal e kryer nga Prokurori i Përgjithshëm në raportin e paraqitur pranë Kuvendit të Shqipërisë, në veçanti politika penale dhe siguria publike, si dhe të dhënat për viktimat dhe kostot e shpenzimeve procedurale në fazën e hetimeve.

Prokurori i Përgjithshëm, sipas nenit 38, pika 1, të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, është drejtuesi i Prokurorisë së Përgjithshme dhe ka përgjegjësi për punën e Prokurorisë së Përgjithshme dhe të prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm të apelit dhe shkallës së parë, por mjetet shtrënguese ligjore për ushtrimin e këtyre përgjegjësive janë të kufizuara, ndaj Prokurori i Përgjithshëm ka adresuar nevojën për disa ndryshime ligjore që i shërbejnë mirëfunksionimit të sistemit të prokurorisë.

Bazuar sa më sipër, për vitin 2022 Kuvendi i Shqipërisë i rekomandon institucionit të Prokurorisë së Përgjithshme:

1. Të vijojë rritja e rolit proaktiv të prokurorit në hetimin paraprak, në funksion të shtimit të hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë, duke zbatuar standardet më të mira në drejtim të garantimit të të drejtave të njeriut në procedimet penale, të drejtat për proces të rregullt, të parimit të barazisë së shtetasve përpara ligjit dhe parimit të proporcionalitetit, parimit të ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë.

2. Të nxisë prokurorët dhe oficerët e Policisë Gjyqësore për të pasur më shumë fokus, përgjegjshmëri, hetime kryesisht dhe proaktive për veprat penale në fushën e korrupsionit, referuar kompetencës lëndore të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, përfshirë përdorimin me efikasitet të teknikave proaktive të hetimit, për aq sa është e mundur duke vlerësuar me prioritet efektivitetin e strukturave të ngritura për parandalimin dhe goditjen e veprave penale në fushën e pastrimit të parave, të lidhura me to.

3. Të vijojë punën për konsolidimin e pavarësisë institucionale dhe funksionale të institucionit të prokurorisë dhe veçanërisht pavarësinë e prokurorëve në procesin e hetimit dhe vendimmarrjes në çështjet përkatëse duke konsideruar tejet të rëndësishme gjithashtu përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e tyre në funksion të rezultateve më të mira në luftën kundër krimit.

4. Të punojë për forcimin e mekanizmave për rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së brendshme të oficerëve të Policisë Gjyqësore, për eficientë dhe efikasitetin e punës, pa cenuar procesin e rregullt ligjor gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, si dhe të vijojë nxitja e prokurorëve që të ushtrojnë kontroll efektiv në punën e oficerëve të Policisë Gjyqësore, si dhe të evidentohen rastet që duhen proceduar në rrugë disiplinore.

5. Të merren masa për rritjen e cilësisë së hetimeve për veprat penale të dhunës në familje dhe veprave penale ndaj të miturve, si dhe të vijojë mbikëqyrja e zbatimit të udhëzimeve me karakter të përgjithshëm në këtë drejtim, përfshirë edhe aspekte të krijimit të statistikave të reja dhe raportimit periodik të të dhënave të sakta statistikore.

6. Të merren masa efektive për mbrojtjen e viktimave të veprave penale të dhunës në familje dhe veprave penale ndaj të miturve dhe të rritet bashkëpunimi me institucionet shtetërore që ngarkohen me përgjegjësi në këtë drejtim sipas legjislacionit në fuqi.

7. Të vijojë puna për vlerësimin e kapaciteteve profesionale, teknologjike dhe marrjen e masave të tjera për ngritjen sa më parë të sistemit të menaxhimit të çështjeve në bashkëpunim me Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

8. Të konsolidohet metodologjia dhe transparenca në hedhjen e shortit elektronik për ndarjen e çështjeve, si dhe të vijojë puna e nisur për zhvillimin dhe përfundimin e sistemit

elektronik PRESTO për administrimin elektronik të regjistrave proceduralë dhe përfitimin e statistikave në kohë reale me të dhëna gjithëpërfshirëse.

9. Të vijohet me përmirësimin më tej të efijencës së bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese palë në marrëveshje dy ose shumëpalëshe, si dhe në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet gjyqësore të huaja nëpërmjet Zyrës së Prokurorit ndërlidhës të Shqipërisë në Eurojust, veçanërisht për rritjen e numrit të skuadrave të përbashkëta hetimore dhe goditjen e veprimtarisë kriminale brenda dhe jashtë vendit.

10. Të vijojë rritja e bashkërendimit dhe koordinimit me Komisionin e Policisë Gjyqësore për forcimin e kapaciteteve profesionale të oficerëve të Policisë Gjyqësore në strukturat përkatëse të shërbimeve dhe seksioneve të Policisë Gjyqësore, me synim rritjen e cilësisë dhe efektivitetit në kryerjen e hetimeve në drejtimet prioritare të luftës kundër kriminalitetit në zbatim të Kodit të Procedurës Penale.

11. Të vijojë fuqizimi i bashkëpunimit me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur ndërmjet tyre “Për kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike dhe për shkelje individuale të magjistratëve prokurorë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm” dhe të vijohet roli proaktiv i Prokurorit të Përgjithshëm në bashkëpunimin me Këshillin e Lartë të Prokurorisë për të adresuar problematikat e moszbatimeve të udhëzimeve me karakter të përgjithshëm nga drejtues të prokurorisë.

12. Të vijojë fuqizimi i bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale që lidhen sidomos me trafikimin e narkotikëve, pastrimit të parave, financimin e terrorizmit, trafikimin e qenieve njerëzore, krimeve mjedisore.

13. Të vijojë puna e nisur për forcimin e kapaciteteve profesionale në luftën kundër korrupsionit, pastrimit të parave dhe veprave penale në fushën e zgjedhjeve të lira, fushën e narkotikëve, veçanërisht sa i përket prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike, si dhe hetimin e veprave penale që lidhen me zhvillimin e paligjshëm të lojërave të fatit, nëpërmjet organizimit dhe zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta trajnuese me institucione/agjenci ligjzbatuese, në bashkëpunim edhe me misionet e projektet ndërkombëtare që asistojnë sistemin e prokurorisë.

14. Të vijojë puna e nisur për përditësimin e manualit për pastrimin e parave dhe rikuperimin e asetëve në kuadrin e projektit FIIAPP.

15. Të angazhohet në procesin e zbatimit të hartës së re gjyqësore, duke synuar garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit, me theks të veçantë tek e drejta e aksesit në drejtësi.

16. Së bashku me strukturat përgjegjëse shtetërore, organizatat e shoqërisë civile dhe asistencën e nevojshme ndërkombëtare të kontribuojë në krijimin e një qasje të integruar të politikës penale në luftën kundër kriminalitetit si një nevojë tashmë imediate e shoqërisë sonë, me fokus parandalimin e kriminalitetit tek të miturit dhe të rinjtë.

17. Të vijojë përpjekjet për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit me Bashkimin Europian referuar rekomandimeve të lëna në progresraportin e datës 19.10.2021.

Miratuar në datën 14.7.2022